



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 06.03.2024)*

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësisimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 239, nr.240, nr.243, datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 12:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Emona Muçi*** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Irena Plaku*** (anëtare)

8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)  
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 239, nr.240, nr.243, datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Atëherë, fillojmë mbledhjen e radhës, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 6 mars.

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit kërkohet vendimmarrje përreth 15 çështje. Për shkak të një urgjence që ka ardhur mbi nevojën që ka gjykata e posaçme e shkallës së

parë për plotësimin e trupës gjyqësore me një gjyqtar, unë do të propozoja që të përfshihet edhe kjo në rendin e ditës, nëse nga ana e kolegëve janë dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë shtohet.

**Naureda Llagami:** Fillojmë mbledhjen. Në mungesë është vetëm z. Markelian Koça, i cili për shkak të dorëheqjeve që ka bërë, e ka të pamundur që të jetë në çështjet që janë për shqyrtim nga ana e Këshillit.

Pa humbur kohë fillojmë me çështjen e parë që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit...”. Për më shumë detaje, ia jap fjalën z. Alban Toro.

**Alban Toro:** Faleminderit!

Më herët nga ana e Këshillit janë hapur disa pozicione për ngritjen në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të hapura me vendimet nr. 239, 240, 243, 24.05.2023, ku një nga kandidatet që ka konkurruar në këto pozicione është edhe zonja {...}, aktualisht gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Me cilësinë e relatorit kam administruar aktet e nevojshme me qëllim provueshmërinë e plotësimin të kritereve të parashikuara në nenin 8/3, 47/4, 48/8 të ligjit “Për statusin”, nga të cilat ka rezultuar se:

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në datë 30.06.1994 dhe ka përfunduar studimet Master i “Nivelit të Dytë” në “Shkenca Juridike Civile”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2011. Me vendim nr. {...}, datë 30.03.1995 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet ndihmësgjyqtare efektive në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Me dekret nr. {...}, datë 13.05.2000 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendim nr. 137, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 28 vite. Aktualisht nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat rezulton që znj. {...}, të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale, rezulton se znj. {...} ka gjykuar nga viti 2008 deri në vitin 2015 në seksionin tregtar dhe më pas nga viti 2015 e në vazhdim në seksionin civil / tregtar. Edhe në këtë kontekst plotësohet kriteri minimal mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.

Aktualisht nuk rezulton në akte të ketë masë disiplinore në fuqi apo ndonjë shkak të papajtueshmërisë ambientale.

Në këtë kuadër, në përfundim relatori ka përgatitur projektvendimin i cili ju sugjeron të miratojë në këtë formë të paraqitur, ku në dispozitiv do të gjeni:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 239, nr.240, nr.243, datë 24.05.2023, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të

Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 239, nr.240, nr.243, datë 24.05.2023

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Kemi ndonjë diskutim?

Kalojmë në votim.

*Ilir Rusi:* Dakord.

*Irena Plaku:* Pro.

*Gentiana Muçaj:* Dakord.

*Ridvan Hado:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Yllka Rupa:* Pro.

*Emona Muçi:* Dakord.

*Klodian Kurushi:* Dakord.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit të relatorit.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 06.03.2024)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësisimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 12:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Emona Muçi*** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Irena Plaku*** (anëtare)

8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)  
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek akti tjetër që është edhe ky për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kritereve për zonjën {...}. Sërish fjalën e ka z. Alban Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Me vendimin nr. 239, 24.05.2023, të KLGJ-së është vendosur hapja e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë në fushën e të drejtës civile. Kandidat në këtë pozicion është edhe znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Me cilësinë e relatorit kam administruar aktet të cilat provojnë përmbushjen e kritereve të parashikuara në nenin 8/3, 47/4, 48/8 të ligjit “Për statusin”.

Në këtë kontekst është verifikuar përvoja minimale 7-vjeçare ku 5 vjet në fushën e të drejtës civile, të drejtës përkatëse, të përshtatshme për pozicionin e lirë. Është administruar dokumentacioni i nevojshëm nga Burimet Njerëzore, ku rezulton që kandidatja {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në datën 30.06.2005 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2009. Me dekretin nr. {...}, datë 07.01.2009 të Presidentit të Republikës caktohet të kryejë stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin nr. {...}, datë 25.06.2010 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Me vendimin nr. 432, datë 14.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor komandohet në pozicionin Ndihmësmagjistrat në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, me një afat 3-vjeçar. Me vendimin nr. 137, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, caktohet në pozicion të përhershëm pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Me vendimin nr. 532, datë 12.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet përfundimi i kohëzgjatjes së komandimit në pozicionin Ndihmësmagjistrat në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë dhe kthimi i gjyqtares në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku dhe aktualisht ushtron funksionin. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 15 vite. Znj. {...} aktualisht nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Përfundimisht ajo rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

Në lidhje me përvojën specifike, sipas informacionit të administruar dhe përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezulton që



kandidatja të ketë gjykuar gjithsej 159 çështje me natyrë të përgjithshme civile, për periudhën 01.01.2009-31.12.2009 dhe për periudhën 12.10.2023 - 26.02.2024.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë rezulton që kandidatja referuar dhe urdhrin nr. {...} prot., datë 06.07.2010 dhe nr. {...} prot., datë 06.01.2011 të kryetarit të gjykatës ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve si civile dhe penale.

Sipas informacionit të administruar nga Gjykata Lartë, rezulton se znj. {...} është emëruar në Njësinë e Shërbimit Ligjor me vendimin nr.432, datë 14.10.2020 të KLGJ dhe urdhrin nr.195, datë 20.10.2020 të zv/kryetarit të Gjykatës së Lartë, z.{...}. Atashimi i këshilltarëve ligjorë të Njësisë së Shërbimit Ligjor, pranë kolegeve administrative, civile apo penal në Gjykatën e Lartë bëhet sipas nevojave të kolegeve përkatës në kohën e komandimit të ndihmësmagjistratëve apo të emërimit të këshilltarëve ligjorë me vendimet përkatëse të KLGJ-së. Fillimisht znj. {...} është atashuar pranë kolegjit civil dhe administrativ nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë sipas nevojave të kolegeve përkatëse në respektim të pikës 3, neni 34 i ligjit nr.98/2016, e vërtetuar me dosjet e marra në ngarkim nga arkivi i gjykatës si dhe të relacioneve të pasqyruara në sistemin ICMIS. Aktualisht e ushtron funksionin e këshilltarit ligjor pranë Kolegjit Civil.

Përfundimisht edhe në këtë kontekst ajo rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.

Nuk rezulton të ketë masa disiplinore në fuqi apo ndonjë shkak papajtueshmërie që do të ndalonte konkurrimin e mëtejshëm.

Përfundimisht nga ana e relatorit është përgatitur projektvendimi, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 239 datë 24.05.2023, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm,

për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimit të Këshillit nr. 239 datë 24.05.2023.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Nëse s'kemi diskutime, kalojmë në votim.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga relatori.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 06.03.2024)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësisht nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 242, 244, 247, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 12:20.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                    |                   |
|--------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare)        |
| 2. Ilir Rusi       | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar)          |
| 4. Fatmira Luli    | (anëtare)         |
| 5. Emona Muçi      | (anëtare)         |
| 6. Ridvan Hado     | (anëtar)          |

- |                          |                  |
|--------------------------|------------------|
| <i>7. Irena Plaku</i>    | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i>     | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>9. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Yllka Rupa</i>    | <i>(anëtare)</i> |

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Markelian Koça**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 242, 244, 247, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek akti projekt-akti i radhës që ka të bëjë edhe kjo me shqyrtimin e projektvendimit për verifikimin dhe plotësimin e kushteve nga kandidatja znj. {...}. Për më shumë detaje fjalën ia jap z. Kurushi.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Po prezantoj projektvendimin së bashku me relacionin përkatës për verifikimin e kushteve dhe kritereve formale në lidhje me kandidaten znj. {...}.

Me vendimet nr. 242, 244, 247, datë 24.05.2023, KLGJ-ja ka hapur procedurën e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e së drejtës civile, ndërmjet të tjerave edhe për këto tre pozicione që unë i përmenda më lart. Në këto tre pozicione ka aplikuar kandidatja zonja {...}.

Ndodhur në këto kushte Komisioni pasi mori në shqyrtim kërkesën e zonjës {...} filloi procedurat për verifikimin e kritereve ligjore formale, kritere këto të cilat janë të parashikuara në vendimet e Këshillit 242, 244, 247, datë 24.05.2023.

Rezultatet e verifikimit paraparak për tre kriteret e kandidimit.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale”.

Bazuar në nenin 47, pika 4, të ligjit “Për statusin”, është përcaktuar se: “Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.

Përpara kësaj situate, Komisioni bëri verifikimin fillimisht të tre kritereve ligjore, nga ku ka rezultuar se zonja {...} ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2006; është emëruar për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Durrës, për periudhën tetor 2005 deri më nëntor 2006, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme, çështje civile si dhe çështje penale. Në vijim, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Lushnjë, ku gjatë periudhës prill 2010 – korrik 2014 ka ushtruar funksionin e Kryetares së Gjykatës. Në këtë gjykatë detyrën e ka ushtruar deri më nëntor 2016, kohë në të cilën është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Tiranë ku vijon të ushtrorë funksionin si gjyqtare në seksionin civil.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj.

{...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në datë 30.06.2003 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2006.

Me dekret të Presidentit të Republikës nr. {...}, datë 03.10.2005 emërohet gjyqtare dhe caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Me dekret nr. {...}, datë 06.11.2006 të Presidentit të Republikës caktohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Me vendim nr. {...}, datë 01.04.2010 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë delegohet për të kryer përkohësisht detyrën e Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, funksion të cilin e ka ushtruar deri më datë 23.07.2014.

Me vendim nr. {...}, datë 18.11.2016 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë transferohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendim nr. 137, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 18 vite.

Zonja {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallur me vendimet e Këshillit nr. 242, nr. 244 dhe nr. 247 datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi, kandidatja ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në fushën civile pranë gjykatave të sipërpërmendura për një periudhë mbi 5 vjet.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton që kandidatja prej vitit 2016 është pjesë e dhomës civile.

Edhe nga verifikimet e tjera, në mënyrë të përmbledhur, e plotëson kushtin mbi 5

vjet, por edhe nga verifikimet e bëra në gjykata të tjera ku ajo ka ushtruar funksionin, ka rezultuar që ajo ka punuar në dhomën civile dhe dhomën penale në këtë periudhë. Kështu që nga të dhënat rezulton se zonja {...} plotëson kriterin minimal të përvojës specifike profesionale mbi 5 vjet.

Zonja {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi. Zonja {...} nuk ka shkaqe të papajtueshmërisë ambientale nga ato që parashikon neni 8, pika 2 e ligjit “Për statusin”.

Ndodhur në këto kushte zonja {...} plotëson verifikimin e kriterëve formale dhe propozojmë që të pranohet propozimi ynë për verifikimin e kriterëve formale të kandidimit të zonjës {...}.

Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit z. Kurushi!

Atëherë, nëse s’kemi diskutime, kalojmë në votim sipas propozimit të bërë nga relatori.

*Ilir Rusi:* Dakord.

*Irena Plaku:* Pro.

*Gentiana Muçaj:* Dakord.

*Ridvan Hado:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Yllka Rupa:* Pro.

*Emona Muçi:* Dakord.

*Klodian Kurushi:* Dakord.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga relatori.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 06.03.2024)*

***Pika 4 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësisimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 12:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Emona Muçi*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Irena Plaku*** (anëtare)



8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)  
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti i radhës që edhe kjo ka të bëjë me verifikimin e plotësimit e kushteve dhe kritereve nga kandidatja zonja {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile. Sërisht është z. Kurushi

relator.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit zonja Kryetare!

Zonja {...} ka shfaqur interesin për të kandiduar në pozicionin e shpallur me vendimin e KLGJ-së nr. 244, datë 24.05.2023.

Janë të njëjtat situata të cilat unë i përmenda edhe në relacionin pararendës, kështu që nuk dua që të kaloj në përsëritje. Kështu që në mënyrë të përmbledhur po them vetëm rezultatet e verifikimit.

Zonja {...} plotëson kriterin e përvojës profesionale minimale. Ajo ka mbi 7 vite gjyqtare magjistrate në funksion si gjyqtare e shkallës së parë në Vlorë dhe më pas në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë. Njëkohësisht një pjesë të përvojës së saj ajo e ka ushtruar edhe funksionin e magjistratit të komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pra përvoja mbi 7 vite është e plotësuar nga zonja {...}.

Nga të dhënat e tjera, nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit zonja {...} deri në momentin e kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 244 datë 24.05.2023, rezulton që ajo ka një përvojë mbi 15 vite si magjistrate.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton që kandidatja referuar dhe urdhrin nr. {...} datë 16.10.2012; nr. {...} datë 23.10.2012; nr. {...} datë 21.11.2012; nr. {...} datë 11.12.2012; nr. {...} datë 04.02.2013; nr. {...} datë 07.05.2013; rezulton që ka ushtruar funksionin e magjistratit dhe ka gjykuar çështje të natyrës civile, familjare dhe penale gjatë të gjithë periudhës së stazhit profesional; ndërsa për periudhën mars 2023 e në vijim kjo gjyqtare është pjesë e dhomës civile, pranë seksionit familjar. Para periudhës mars 2023, domethënë përpara se ajo të shkonte në dhomën penale.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton ajo që ju thashë më sipër. Zonja {...} plotëson kriteret edhe të përvojës specifike minimale profesionale. Ajo ka mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës civile.

Nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Nuk ka shkak të papajtueshmërisë ambientale, referuar verifikimit që kemi bërë ne dhe deklaratës që kemi marrë nga zonja {...}.

Kështu që ne si Komision propozojmë, pra plotëson kushtet formale të kandidimit për kërkesën që ka paraqitur për ngritje në detyrë.

Faleminderit!

***Hidhet në votim propozimi:***

***Illir Rusi:*** Dakord.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Emona Muçi:*** Dakord.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga relatori.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 06.03.2024)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësisht nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244, 246, 247 datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 12:20.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Emona Muçi* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)

7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Markelian Koça**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
4. **Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
6. **Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.**
7. **Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244, 246, 247 datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti i radhës që edhe kjo ka të bëjë me verifikimin e plotësimit e kushteve për kandidatin {...}, i cili ka aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në

fushën e të drejtës civile. Sërish fjalën e ka z. Kurushi.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit zonja Kryetare!

Zoti {...} ka shfaqur interesin e tij duke kandiduar në pozicionet nr. 244, 246, 247, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në fushën e të drejtës civile.

Referuar nenit 47 të ligjit “Për statusin”, Komisioni fillimisht ka bërë verifikimet e tre kritereve formale që lidhen me përvojën specifike minimale, masën disiplinore dhe papajtueshmërinë ambientale.

Lidhur me përvojën si magjistrat të z. {...} rezulton që zoti {...} plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara nga neni 47 i ligjit “Për statusin”. Ai ka mbi 7 vite magjistrat në detyrë në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Në lidhje me përvojën specifike minimale, atë prej 5 vitesh, nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit të z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallur me vendimet nr. 244, nr. 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.

U verifikua edhe kriteri i mospasjes masë disiplinore në fuqi. Deri tani nuk ka rezultuar që zoti {...} të ketë masë disiplinore në fuqi gjatë periudhës që ai ka paraqitur kërkesën për kandidim.

Njëkohësisht u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”. Së bashku me verifikimet që kemi bërë, zoti {...} ka paraqitur edhe deklaratën e tij personale që nuk ka shkaqe të papajtueshmërisë ambientale nëse ai do të promovohet në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Ndodhur në këto kushte, ne përfundimisht si Komision propozojmë që zoti {...} plotëson kriteret formale të kandidimit për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit!

Nëse s'kemi diskutime, kalojmë në votim.

*Illir Rusi:* Dakord.

*Irena Plaku:* Pro.

*Gentiana Muçaj:* Dakord.

*Ridvan Hado:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Yllka Rupa:* Pro.

*Emona Muçi:* Dakord.

*Klodian Kurushi:* Dakord.

*Naureda Llagami:* Dakord.

*(Miratohet projekt-akti.)*

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

*(Miratohet projekt-akti sipas propozimit.)*

\* \* \*

(Pika 11 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 06.03.2024)*

***Pika 12 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 12:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Emona Muçi*** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Irena Plaku*** (anëtare)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)

9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)

10. *Yllka Rupa* (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Markelian Koça**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

3. **Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

4. **Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**

6. **Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.**

7. **Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500/2022, për kandidaten {...}. Edhe për këtë projekt-akt relator është z. Toro.

**Alban Toro:** Faleminderit sërish!

Edhe për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vijuar procedurën e plotësimit të pozicioneve të lira që gjenden në të. Një nga përpjekjet është edhe vendimi nr. 500, datë 21.11.2022 për të cilën nga kandidatet konkurruese ka qenë {...}, e cila aktualisht gjyqtare e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Për këtë kandidate janë kryer disa veprime procedurale të cilat do të finalizonin procedurën, ndërkohë mund të përmend vendimin nr. 66, datë 09.02.2023 me anë të së cilës është filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504, datë 21.11.2022. Në këtë kontekst, nga ana e relatorit janë administruar aktet e nevojshme, të cilat më pas janë dërguar pranë Këshillit i cili me Vendimin nr. 204, datë 26.04.2023, ka vendosur:

“1.Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 500, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2.Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 500, datë 21.11.2022.”

Më herët zonja Goxha kishte aplikuar për ngritje në detyrë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Këshilli me vendimin nr.59, datë 07.02.2024 vendosi: “Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të znj. {...}”.

Ndërkohë nga kjo e fundit na paraqitet një kërkesë për heqje dorë nga kandidimi

për ngritje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar duke parashtruar si vijon:

“Në kushtet kur jam ngritur në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin nr.59, datë 07.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, paraqes kërkesën time për heqjen dorë nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e shpallur me vendimin nr.500 datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”.

Për sa kohë që ky është edhe vullneti i gjyqtares i cili është parashikuar si rast për ndalimin e çdo lloj konkurrimi të mëtijshëm të parashikuar në pikën 17, Seksioni B, Kreun VI, i Vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, nga ana e relatorit është përpiluar projekt-akti në dispozitivin e të cilit ju propozohet të miratoni:

1.Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime kalojmë në votimin e projekt-aktit të propozuar.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

*Emona Muçi*: Dakord.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit.

\* \* \*

(Pika 12 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 06.03.2024)*

**Pika 13 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 57, datë 07.02.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247, datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 12:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Emona Muçi*** (anëtare)

- |                          |                  |
|--------------------------|------------------|
| <b>6. Ridvan Hado</b>    | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>7. Irena Plaku</b>    | <b>(anëtare)</b> |
| <b>8. Alban Toro</b>     | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>9. Gentiana Muçaj</b> | <b>(anëtare)</b> |
| <b>10. Yllka Rupa</b>    | <b>(anëtare)</b> |

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Markelian Koça**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Krytares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Priifti, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 57, datë 07.02.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247, datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek pika 13 që ka të bëjë me ndryshimin e vendimit nr. 57, datë 07.02.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile [...]”.

Atëherë, ftojme administratën.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e qelqit futen shiritat me emrat e dy anëtarëve të Komisionit (sipas propozimit të bërë në relacionin e KZHK-së): Shiriti i parë me emrin e z. Ridvan Hado (anëtari zëvendësues) dhe shiriti i dytë me emrin e z. Klodian Kurushi. *(Zoti Toro nuk mund të jetë pjesë e shortit, në kushtet kur pas kërkesës së bërë nga kandidati z. {...} për përjashtimin si relator dhe zëvendësimin e tij me një relator tjetër, ai ka bërë një kërkesë për heqje dorë nga ky proces, kërkesë e cila është miratuar me vendim të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor).*

Procedura e përzgjedhjes:

Për kandidatin z. Albert Meça, relator përzgjidhet z. Ridvan Hado.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në votim projekt-aktin.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:



1. Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 57, datë 07.02.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247, datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, nënpika 22, si më poshtë:

Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...} - relator z. Ridvan Hado.

\* \* \*

(Pika 13 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 06.03.2024)*

**Pika 14 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022 për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 12:20.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Emona Muçi* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...}.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

14. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022 për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë të shpallur me vendim nr. 178, datë 11.05.2022, për kandidatin z. {...}. Për më shumë detaje fjalën e ka z. Kurushi.

*Klodian Kurushi:* Faleminderit zonja Kryetare!

Relacioni i radhës ka për objekt shqyrtimin e projektvendimit për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022 për kandidatin z. {...}.

1. Me Vendimin nr. 178, datë 11.05.2022 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale...”

Brenda afatit të kandidimit, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 178, ka kandiduar edhe gjyqtari z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së parë Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, aktualisht anëtar i Këshillit.

Vendimin nr. 220, datë 20.06.2022, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e datës 11.05.2022, Këshilli ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit... II. Caktimin e relatorit për kandidatin z. {...} - relator z. {...};...”

Në lidhje me plotësimin e kriterëve formale, Këshilli me vendimin nr. 366, datë 13.09.2022 ka vendosur: Verifikimin e plotësimit e kriterëve formale për kandidatin.

Në përfundim të procedurës së verifikimit për kandidatin z. {...}, në lidhje me kriteret e pasurisë dhe atë të figurës, të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, Këshilli me vendimin nr. 83, datë 16.02.2023, ka vendosur: “1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022.”

Kandidati më datë 16.01.2024, ka paraqitur në Këshill kërkesën ku shpreh vullnetin e tij për heqjen dorë nga kandidimi për ngritjen në detyrën në vendin vakant të Gjykatës së Lartë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 178/2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në rrethanat e mësipërme u përgatit edhe relacioni përkatës sipas pikës 17, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, ku përcaktohet se: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i

çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit”.

Ndodhur në këto kushte ne paraqesim projektvendimin përkatës, ku për shkak të tërheqjes, i propozojmë Këshillit:

Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për z. {...}.

Faleminderit!

*Naureda Llagami*: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, nëse s’kemi diskutim, kalojmë në votim të projekt-aktit.

*Ilir Rusi*: Dakord.

*Irena Plaku*: Pro.

*Gentiana Muçaj*: Dakord.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Emona Muçi*: Dakord.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, miratohet sipas propozimit të ardhur nga relatori.

\* \* \*

(Pika 14 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 06.03.2024)*

**Pika 15 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 12:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Emona Muçi*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Irena Plaku*** (anëtare)

8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)  
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

15. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarinimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me deklarinimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ato ku ushtrojnë

funksionet në mënyrë të përhershme.

Shkurtimisht fjalën ia jap z. Kurushi.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit!

Deri më datë 27.02.2024, pranë KLGJ-së, janë për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, e Zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas të dhënave të mëposhtme, ku bëhet fjalë për katër çështje “Shpërblim dëmi”, “Pagim page”, “Pagim page” dhe “Rillogaritje page”.

Në lidhje me kërkesat si më sipër, Gjykata Administrative e Apelit me shkresën nr. {...}, datë 23.02.2024 ka bërë me dije se “...ju njoftojmë se referuar vendimit nr. {...} prot, datë 20.11.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit, është çmuar se nuk ekzistojnë shkaqe që kualifikohet se përbëjnë rrethana konkrete për arsye serioze njëanshmërie dhe nuk përbëjnë shkaqe të përligjura për të kërkuar heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjeve administrative në fjalë”.

Për rrjedhojë, nevoja për kërkesat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, aktualisht nuk ekziston më, pasi nevoja për caktimin e gjyqtarëve në çështjet konkrete do të plotësohet përmes gjyqtarëve të cilët ushtrojnë funksionin në këtë gjykatë.

Në këto kushte, kërkesa si më lart e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë tashmë ka mbetur pa objekt, prandaj është vendi që Këshilli të vendosë për deklarimin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative.

Sipas nenit 90/3 të Kodit të Procedurave Administrative, “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Ndërsa sipas nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim



përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

Propozimi:

Nisur nga rrethanat si më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

- Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë si vijon:

1. Kërkesë nr. {...} prot., datë 07.11.2023, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me palë: paditës {...}, e paditur: {...}, {...}, me objekt: “Detyrim shpërblim dëmi...”,.

2. Kërkesë nr. {...} prot., datë 16.11.2023, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me palë: paditëse {...}, palë të paditur Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, KLGJ m objekt: “Detyrim njohje page referuese...”,

3. Kërkesë nr. {...} prot., datë 17.11.2023, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me palë: paditëse {...}, palë të paditur Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, KLGJ me objekt: “Detyrim pagim diferencat e pagës ...”,

4. Kërkesë nr. {...} prot., datë 21.11.2023, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me palë: paditëse {...}, palë të paditur Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, KLGJ me objekt: “Detyrim rilogaritje të pagës ...”.

Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Kalojmë në votimin e projekt-aktit?

***Ilir Rusi:*** Dakord.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Emona Muçi:*** Dakord.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit.

\* \* \*

(Pika 15 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 06.03.2024)*

**Pika 16 shtesë e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Kurushi).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 12:20.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Emona Muçi* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Markelian Koça**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

16 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Kurushi).

**Naureda Llagami:** Siç ramë dakord të gjithë bashkë, çështja e fundit që ne shtuam në rendin e ditës është hedhja e shortit për caktimin e një gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Sërish fjalën e ka zoti Kurushi.

**Klodian Kurushi:** Faleminderit Kryetare!

Deri më datë 05.03.2024, pranë KLGJ-së, është regjistruar për trajtim kërkesa për

caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, të Zëvendëskryetares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas të dhënave të më poshtme: (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës bashkëlidhur relacionit.)

Lidhur me të dhënat e çështjes: Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët {...} dhe {...}. Kanë pengesë gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} pasi kanë kryer veprime paraprake. Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin nr. 26, viti 2023 në ngarkim të të bashkëpandehurve {...} dhe {...}; Gjyqtare {...} si gjyqtare e seancës paraprake ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim.

Ndër të tjera zoti Kurushi parashtron se:

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në konsideratë të kriterëve të përcaktuara në paragrafin X/2 të Vendimit të KLGJ-së, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon se gjykata nga duhet të përzgjidhet gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtari për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhet me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1(një).

Gjithashtu Komisioni propozon:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtari {...} për shkak të ngarkesës që ka me çështjet që i janë caktuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të

Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se një skemë e tillë e caktimit të gjyqtarëve për atë çështje gjyqësore të veçantë të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është mundësia më e mirë për përmbushjen e nevojave të kësaj të fundit.

Bashkëlidhur relacionit kemi paraqitur edhe listën e gjyqtarëve të cilët plotësojnë kushtet për t'iu nënshtruar shortit dhe për të gjykuar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në listë është vendosur edhe emri i gjyqtares zonjës {...}, e cila aktualisht nuk plotëson më kushtet për të gjykuar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pasi ajo është ngritur në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Pra zonja {...} duhet të përjashtohet nga shorti.

*Duke qenë se anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit, vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për kërkesën 772, gjyqtare e përzgjedhur Marçela Shehu.

Mbyllet procedura e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

\* \* \*

(Pika 16 shtesë e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**